

www.gjykataelarte.gov.al



REVISTA DIGJITALE

DIALOG JURIDIK

REFLEKTIME GJYQËSORE

2026

Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese si gjykata të të drejtave themelore

Darian Pavli

Gjyqtar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Arkitektura e sistemit aktual shqiptar për mbrojtjen e të drejtave themelore është nga më garantistët në Europë. Kjo për shkak se kuadri kushtetues shqiptar garanton tashmë një ankim kushtetues individual dhe gjithëpërfshirës, mbi të gjithë katalogun e të drejtave materiale dhe procedurale. Si rrjedhim, këto të drejta mund të rivendikohen në të tre nivelet e gjyqësorit të zakonshëm dhe, në instancë të fundit dhe të specializuar, nga Gjykata Kushtetuese.

Në të njëjtën kohë, amendimet kushtetuese të vitit 2016 kanë sjellë ndryshime të rëndësishme edhe në juridiksionin dhe profilin institucional të dy gjykatave më të larta në vend; dhe, si rrjedhim, edhe në marrëdhënien mes tyre, e cila mund të thuhet se është në evolucion të vazhdueshëm.

Ndërkohë që raportet me Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Strasburgut janë shumë-dimensionale, në këtë vështrim të shkurtër do të ndalem vetëm në disa prej tyre dhe kryesisht prej këndvështrimit (modest dhe të pjesshëm) të rolit eventual të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) në çështjet shqiptare. Shpresoj se do të jetë e qartë në vijim se sfidat që lidhen me shterimin e mjeteve të brendshme, rihapjen e proceseve etj. prekin në mënyrë organike procedurat përpara të treja këtyre gjykatave, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Natyra e rekursit në Gjykatën e Lartë dhe roli i saj institucional

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, të pasqyruara më tej në kodet e procedurës civile dhe penale, e kanë ridimensionuar ndjeshëm juridiksionin e Gjykatës së Lartë. Ai konsiston tashmë në tre funksione të përzgjedhura: së pari, në *njësimin ose zhvillimin* e praktikës gjyqësore nga tre kolegjet, ndërkohë që *ndryshimi* i praktikës i është rezervuar Kolegjeve të Bashkuara. Së dyti, atë që mund të quhet funksioni disiplinues i kësaj gjykate: ndreqjen e devijimeve të gjykatave më të ulëta nga praktika (e konsoliduar) e kolegjeve të Gjykatës së Lartë.¹ Dhe së treti, në evidentimin e shkeljeve të rënda procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose procedurës më të ulët.²

Me distancën e një dekade, ky ridimensionim ka qenë aq domethënës sa duket se i është dashur mjaft kohë sistemit juridik shqiptar për t'u mësuar me të. Një interpretim literal i neneve përkatëse do të çonte në përfundimin se, për çdo aspekt tjetër ligjor apo faktik, janë vendimet e themelit të gjykatave të apelit që duhet të konsiderohen si përfundimtare. Sipas të njëjtës qasje, nëse shkaqet e rekursit nuk formulohen (dhe kufizohen) bindshëm në funksion të një nga tre shkaqeve të mësipërme, ato duhet të trajtohen si të papranueshme. Nën këtë logjikë, sistemi shqiptar i ankimit gjyqësor nuk bazohet më në tre nivele, por në dy nivele të plota dhe një

¹ Ky funksionin disiplinor duket se presupozon një shmangje të dukshme nga *interpretimi* i mëhershëm i ligjit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe jo thjesht dyshime në lidhje me *zbatimin* e drejtë të tij në rrethanat konkrete të çështjes.

² Shih përkatësisht nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) dhe nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Në të njëjtin drejtim shkon edhe Ligji nr. 49/2012 për gjykatat administrative, i ndryshuar.

rekurs të kufizuar kasacional – duke e kthyer Gjykatën e Lartë, në thelb, në një “gjykatë njësuese”.

Për më tepër, kjo nënkupton se Gjykata e Lartë do të gëzonte një diskrecion të konsiderueshëm në vlerësimin se cila çështje janë të përshtatshme për njësimin/zhvillimin ose ndryshimin e praktikës – një tagër që mund të konsiderohet jo shumë larg modelit *certiorari* në bazë të së cilit funksionon Gjykata Supreme e SHBA-së.

Opinion i botuar në këto faqe nga gjyqtari Asim Vokshi, ish-gjyqtar i Gjykatës së Lartë dhe aktualisht anëtar i Gjykatës Kushtetuese, duket se na shtyn pikërisht drejt këtij interpretimi literal të shkaqeve të rekursit. Kjo pasqyron ndoshta një vlerësim se dhe vetë Gjykata e Lartë ende nuk e ka përqafuar tërësisht, apo në mënyrë uniforme, këtë rikonceptim të juridiksionit të saj. Në fakt, e njëjta përshtypje krijohet edhe nga leximi i disa vendimeve të papranueshmërisë, të marra nga trupat prej tre gjyqtarësh të kësaj gjykate, të cilat jo rrallë përpiqen të trajtojnë, qoftë dhe shkurtimisht, motivet e rekursit që lidhen me themelin e vendimit të gjykatës më të ulët. Po ashtu, vendimet e themelit të Kolegjeve jo domosdoshmërisht ndjekin një strukturë dhe qasje që do ta kanalizonte analizën (ekskluzivisht) në një prej shkaqeve që parashikon legjislacioni.³

Roli parandalues i Gjykatës së Lartë

Konteksti i mësipërm ngre disa pikëpyetje interesante nga këndvështrimi i rolit të Gjykatës së Lartë si një gjykatë konventore (apo e të drejtave themelore). Pikësëpari, duke qenë se Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut përbën pjesë të së drejtës sonë të brendshme, a duhet ta lexojmë referimin ndaj “zbatimit të gabuar të *ligjit* material ose procedural” në nenet përkatëse të kodeve të procedurave si një koncept që përfshin edhe zbatimin e gabuar të Konventës? Në dijeninë time, Gjykata e Lartë nuk është shprehur në mënyrë eksplicite mbi këtë aspekt, apo qoftë dhe se çfarë përbën keqzbatim të ligjit “*me rëndësi themelore*” për njësimin ose zhvillimin e praktikës. Natyrisht, një interpretim i mundshëm do të përfshinte në këtë kategori ato raste kur gjykatat e apelit kanë devijuar nga interpretimet e konsoliduara të Konventës që ka bërë vetë GjEDNJ-ja, pretendime të cilat janë ngritur shprehimisht në rekurs. Një tjetër interpretim do ta kufizonte ndërhyrjen e kësaj Gjykate vetëm në rastet kur keqzbatimi i Konventës vjen si pasojë e një praktike të zgjeruar apo sistematike të gjykatave të faktit. Ndërkohë që kjo qasje e fundit nuk do të ishte e paarsyeshme në vetvete, është e qartë se ajo do t’ia kalonte barrën e parandalimit të shkeljeve, në shumicën e rasteve konkrete, Gjykatës Kushtetuese.

Nuk ka asnjë dyshim se Gjykata e Lartë jo vetëm mundet, por edhe luan në praktikë një rol shumë të rëndësishëm për ‘përkthimin’ e standardeve konventore në praktikën gjyqësore në nivel kombëtar. Ndër mjaft shembuj të mundshëm, mund të përmend nismën e fundit për rishikimin e kriterëve për zbatimin e masave të sigurimit personal në procedurat penale. Por a kufizohet ky funksion në formulimin e parimeve të përgjithshme, apo dhe mënyrën se si ato janë zbatuar në çështje konkrete nga gjykatat e mëposhtme?

Kur është rekursi kasacional një mjet efektiv që duhet shteruar?

Një pyetje akoma më delikate lidhet me nevojën e shterimit të rekursit pranë Gjykatës së Lartë, nga këndvështrimi i gjykimit tonë kushtetues, por edhe atij para GjEDNJ-së. Të dyja këto juridiksione (pra kushtetuesi dhe konventori) mbështeten në parimin se ankimet para gjykatave të zakonshme duhen shteruar, por vetëm në atë masë që ato konsiderohen efektive. Nëse ato

³ Duhet theksuar këtu se Kolegji Civil i GjL-së, për shkak të prapambetjes gati 10-vjeçare në evadimin e rekurseve civile, ka zbatuar deri më tani dispozitat mbi shkaqet e rekursit që ishin në fuqi para ndryshimeve të vitit 2017. Qasja e këtij Kolegji në lidhje me kriteret e reja, në fushën civile, do të bëhet më e qartë në vitet në vijim.

janë haptazi joefektive, GJEDNJ kërkon nga individët që të mos shterohen dhe t'i drejtohen asaj brenda 4 muajve nga data e shterimit të mjetit të fundit efektiv.

Në këtë kontekst, nuk është e padëgjuar që GJEDNJ-ja të ketë trajtuar si jo-efektive disa lloj ankimesh para gjykatave më të larta. Për shembull, në çështjen *Secară k. Rumanisë* (2025), Gjykata e Strasburgut mbajti qëndrimin se rekursi i jashtëzakonshëm para Gjykatës së Kasacionit rumune nuk përbën mjet efektiv në rastet kur pala ankohet për mënyrën e marrjes së provave nga gjykatat e faktit (apo çdo aspekt tjetër që nuk lidhet me pesë shkaqet specifike të rekursit penal para asaj gjykate).⁴ Si rrjedhim, ankuesja duhet t'a kishte depozituar ankimin në Strasburg brenda 6 muajve⁵ nga vendimi i gjykatës së apelit, duke e anashkaluar Gjykatën e Kasacionit.

Por një “zgjidhje” e tillë nuk do të ishte aq e thjeshtë në kontekstin shqiptar ku, ndryshe nga rasti rumun, individët gëzojnë qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese, nëpërmjet ankimit individual. Si rrjedhim, në përcaktimin e mjeteve efektive që duhen shteruar në nivel të brendshëm, gjykata ndërkombëtare duhet të marrë parasysh edhe interpretimin që u bën këtyre mjeteve instanca e fundit, pra Gjykata Kushtetuese – në mënyrë që të shmangë krijimin e dilemave procedurale për palët dhe ngërçimin e gjithë regjimit kombëtar të shterimit. Në të njëjtën kohë, nëse një trupë e GJEDNJ-së është e bindur për mungesën e efektivitetit të një mjeti të brendshëm në një rast konkret, ajo do të detyrohej të ndiqte parimet e përgjithshme konventore.

Mund të supozojmë se edhe vetë Gjykata Kushtetuese shqiptare do të përballet me një dilemë të ngjashme (qoftë me nismën e vet apo në bazë të parashtrimeve të ankuesve): nëse merret seriozisht roli i Gjykatës së Lartë si “gjykatë njësuere”, në cilat raste mund dhe duhet të konsiderohet ajo si mjet që duhet shteruar? Natyrisht, kristalizimi i qasjes nga vetë Gjykata e Lartë në lidhje me këtë aspekt thelbësor, jo vetëm juridik por edhe institucional, të rolit të vet do të ndihmonte në gjetjen e përgjigjeve të sakta. Jo vetëm në Tiranë, por edhe në Strasburg.

Së fundmi, kjo do të ndihmonte me gjasë edhe në lehtësimin e tensioneve mes dy gjykatave më të larta në lidhje me sferat e tyre përkatëse të vendimmarrjes, si dhe *thellësinë* e shqyrtimit kushtetues të vendimeve të Gjykatës së Lartë.⁶ Në këtë kontekst, është tërësisht e kuptueshme që trajtimi i efektivitetit të rekursit pranë Gjykatës së Lartë është një vendim madhor, cili duhet marrë pas një reflektimi dhe dialogu të kujdesshëm mes dy gjykatave më të larta në rendin tonë juridik, pa cenuar tagrat dhe rolin thelbësor të secilës, sigurinë juridike dhe garantimin sa më të kënaqshëm të të drejtave themelore të individëve.

Perspektiva e gjykimit kushtetues

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 sollën risi të rëndësishme edhe për juridiksionin dhe rolin e Gjykatës Kushtetuese. Pikësëpari, duke ndrequr një “anomali europiane”, e cila e kishte kufizuar juridiksionin individual të kësaj gjykate në shkeljet e procesit të drejtë ligjor, duke lënë kështu jashtë sferës së shqyrtimit të drejtat kushtetuese materiale. Kjo qasje e para-2016-ës vinte në kontrast edhe me faktin që Kushtetuta shqiptare garanton, në terma mjaft të ngjashme, të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura nga Konventa dhe protokollet e saj. Me plotësimin e juridiksionit, gjykimi kushtetues shqiptar luan tashmë një rol praktikisht ekuivalent me atë të GJEDNJ-së—veçanërisht nga pikëpamja subsidiare e parandalimit të shkeljeve konventore në nivel të brendshëm.

⁴ Shih përmbledhjen e shtypit në këtë [link](#).

⁵ Çështja ishte sjellë para hyrjes në fuqi të Protokollit nr. 15 të Konventës, i cili e uli afatin në 4 muaj.

⁶ Kjo është një tjetër temë komplekse që është cekur në faqet e kësaj Reviste së fundmi nga z. Sokol Sadushi, Kryetar i Gjykatës së Lartë. Ajo shkon përtej suazave të këtij kontributi të shkurtër.

Implementimi i këtij ndryshimi madhor në dekadën e fundit natyrisht që ka kërkuar zhvillimin e qasjeve të reja nga Gjykata Kushtetuese. Ndër të tjera, është dashur që interpretimet e të drejtave materiale të ndërthuren në mënyrë harmonike me jurisprudencën ekzistuese të Gjykatës mbi procesin e drejtë ligjor. Ky proces “shartimi” nuk ka qenë pa sfida dhe disa elementë të “qasjes procedurale” të para 2016-ës janë ende të dukshëm edhe në trajtimin e të drejtave materiale. Sidoqoftë, vendimmarrja e viteve të fundit të Gjykatës Kushtetuese dëshmon, në gjykimin tim, një konsolidim të jurisprudencës së re dhe trajtime gjithmonë e më të sofistikuara, mbi tema komplekse të të drejtave themelore, si dhe me një vëmendje të shtuar ndaj jurisprudencës europiane.

Në vijim do të ndalem shkurtimisht në disa aspekte që kanë të bëjnë me rihapjen e çështjeve: një temë që besoj lidhet natyrshëm me problematikën e trajtuar në pjesën e parë të këtij shkrimi.

Rihapja e çështjes pas një vendimi të GJEDNJ-së: në cilën instancë?

Aktualisht të dy kodet e procedurave parashohin shprehimisht mundësinë e rishikimit të vendimeve penale dhe civile-administrative (të formës së prerë), pas një vendimi të GJEDNJ-së që ka gjetur shkelje të Konventës nga RSH në një rast konkret. Po ashtu, ligji organik i Gjykatës Kushtetuese përmban një dispozitë të ngjashme në lidhje me vendimet e gjykatave ndërkombëtare me juridiksion detyrues mbi Republikën e Shqipërisë (shih shënimin nr. 8 infra). Këto dispozita janë referuar edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit në një çështje që lidhet me rivlerësimin kalimtar (*vetting-un*) e magjistratëve, ku GJEDNJ ka gjetur shkelje të nenit 8 të Konventës. Me mbarimin e mandatit të KPA-së gjatë muajve në vijim, funksionet e saj si instancë ankimore do t’i kalojnë Gjykatës Kushtetuese.

Në parim, “stacioni i parë” për individët që kanë fituar një çështje në Strasburg (dhe kërkojnë rihapjen e procedurës) do të ishte Gjykata Kushtetuese. Kjo për faktin e thjeshtë se, si instancë e fundit, gjykata në fjalë mund të konsiderohet ‘përgjegjëse për ratifikimin’ përfundimtar të qëndrimeve të gjykatave të zakonshme, të cilat kanë rezultuar në cenimin e të drejtave themelore të individit.

Në disa raste, është vetë procedura para GjK-së e cila ka sjellë shkeljen konventore. Për shembull, në këtë kategori futen një numër çështjesh në të cilat GJEDNJ ka gjetur cenim të së drejtës së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si pasojë e llogaritjes problematike të afatit 4-mujor (cf. grup-çështjet *Supergrav*). Në disa prej këtyre çështjeve, pas vendimit të Strasburgut dhe me kërkesë të palës, Gjykata Kushtetuese ka proceduar me prishjen e vendimit të mëhershëm, rihapjen e procedurës dhe shqyrtimin e pranueshmërisë dhe, sipas rastit, themelit të ankimit kushtetues (themel i cili zakonisht mbetet i pashqyrtuar nga GJEDNJ, pikërisht duke marrë parasysh mundësinë e rihapjes në nivel të brendshëm dhe respektimin e parimit të subsidiaritetit).

Megjithatë, pyetja shtrohet nëse e njëjta qasje do të ishte e nevojshme apo e udhës edhe në disa rrethana të tjera—për shembull, në rastet kur shkelja e Konventës ka ardhur si pasojë e interpretimeve të bëra nga gjykatat e zakonshme, të cilat janë ratifikuar në thelb nga GjK, pa identifikuar ndonjë problem kushtetues apo konventor. Në raste të tilla, a do të ishte më efiçente që kërkesa për rihapjen të depozitohej drejtpërsëdrejti me Gjykatën e Lartë? Praktika gjyqësore në lidhje me këtë aspekt duket të jetë ende e pakët dhe tentative.

Natyrisht, një pyetje e ngjashme mund të shtrohet edhe në ato raste kur vetë GjK gjen shkelje si pasojë e vendimeve të gjykatave të zakonshme. Në rast se shkelja është thjesht ‘lënë në fuqi’ nga Gjykata e Lartë, pa një kontribut të shtuar, a do të ishte me vend që ajo të dërgohej për

rigjykim nga gjykata e apelit—po qe nevoja, duke bërë edhe rregullimet e nevojshme ligjore?⁷ Natyrisht që përgjigjja e kësaj pyetjeje nuk mund të jepet në izolim nga problematika e shtruar në pjesën e parë të këtij shkrimi, në lidhje me funksionin e GjL-së.

Së fundmi, ka disa kategori rastesh kur, pavarësisht konstatimit të një shkeljeje kushtetuese apo konventore nga GJykata Kushtetuese, rikthimi i çështjes nuk është i mundur; kjo për arsye se shkelja është konsumuar në kohë dhe nuk mund të zhbëhet nëpërmjet institutit të rishikimit të vendimit. Në këtë kategori hyjnë vendimet në lidhje me masat e sigurimit që janë shuar ndërkohë; apo vendimet për kohëzgjatjen e proceseve në pjesën që kanë të bëjnë me vonesat e konstatuara deri në atë moment (dhe jo përshpejtimin e procedurës pendente).

Në situata të tilla, gjykoj se do të ishte me vlerë që GJykata Kushtetuese të ketë të drejtën t'i akordojë palës së cenuar një *dëmshpërblim monetar të përshtatshëm*, së paku për dëmin moral (jopasuror). Kjo do të forconte qartazi efektivitetin e ankimit kushtetues, si mjet që duhet shteruar nga këndvështrimi i GJEDNJ-së. Po ashtu, do të shmangte nevojën për hapjen e proceseve të reja dhe të mundimshme për individët për marrjen e dëmshpërblimit nga shteti, ndërkohë që vendimi kushtetues do të mjaftohej veç me konstatimin deklarativ të shkeljes. Nëse dhënia e këtij tagri, i cili nuk parashihet shprehimisht në ligjin organik të GjK-së, do të kërkonte ndryshime legislative apo do të mund të bëhej nëpërmjet interpretimit të 'tagrave natyrore' të gjykatës, kjo mbetet për të parë. Mund të vërejmë se në vitet e fundit GjK ka zgjeruar praktikën e saj në lidhje me mbulimin e shpenzimeve të mbrojtjes së individëve gjyqfitues, të cilat i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Vendimi i GJEDNJ-së që gjen shkelje: “judgments” apo dhe “decisions”?

Një tjetër problematikë e pazgjidhur në sistemin tonë lidhet me rihapjen e procedurave në rastet kur shkelja e Konventës në një rast konkret është konstatuar jo nëpërmjet një vendimi themeli të GJEDNJ-së (që njihet si *judgment*), por nëpërmjet një “*strike-out decision*” (vendim për çregjistrimin e çështjes). Kjo praktikë e fundit përdoret nga GJEDNJ-ja kur çështja zgjidhet me mirëkuptim mes palëve, apo nëpërmjet asaj që njihet si deklaratë e njëanshme e Shtetit (*unilateral declaration ose UD*). Nëpërmjet këtyre deklaratave, Qeveria pranon cenimin e të drejtave konventore të personit, si dhe merr përsipër t'i paguaj atij një shumë dëmshpërblimi që GJEDNJ e konsideron të përshtatshme. Po ashtu, rëndom vendimet *strike-out* i referohen mundësisë për rihapjen e procedurës në bazë të legjislacionit të brendshëm, pavarësisht se Qeveria nuk mund ta garantojë në mënyrë absolute këtë rihapje (për shkak të parimit të ndarjes së pushteteve apo motive të tjera).

Janë mjaft Shtete palë të Konventës që kanë bërë të mundur rihapjen e proceseve edhe në bazë të një vendimi *strike-out*: ose duke e paraparë këtë mundësi shprehimisht në ligj ose nëpërmjet interpretimit të zgjeruar të dispozitave ekzistuese. Duke qenë se Qeveria Shqiptare në vitet e fundit e ka përdorur në mënyrë më të qëndrueshme opsionin e UD-ve – gjë që mund të jetë me dobi për të gjitha palët, duke shmangur nevojën e një procedure të plotë kontradiktore dhe me vonesat që kjo presupozon – do të jetë e nevojshme që gjykatat vendase të shprehen në lidhje me këtë aspekt.

Por si e trajton legjislacioni ynë këtë çështje? Përgjigjja nuk është krejtësisht e qartë, qoftë edhe për motive terminologjike apo përkthimi. Neni 450 § 1(d) i K.Proc.Penale i referohet “*vendimit të GJEDNJ-së*”; ndërkohë që neni 494 § 2(ë) i K.Proc.Civile përdor formulën “kur GJEDNJ

⁷ Sipas nenit 76 § 6 të ligjit organik të GjK-së, “[ç]ështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i së cilës është shfuqizuar.” A mund të konsiderohet se në disa raste GjK mund të shfuqizojë si vendimin e Gjykatës së Lartë dhe atë të apelit njëkohësisht?

gjen shkelje të Konventës ...”, pa ju referuar formës së aktit. Ligji organik⁸ i GjK-së ndjek një qasje të ngjashme me atë të KPC-së. Natyrisht, në terminologjinë tonë termi “vendim” i referohet si *judgment*, ashtu dhe *decision* të GJEDNJ-së.

Në gjykimin tim, dispozitat e mësipërme nuk duhet të bëhen pengesë për rihapjen e procedurave në bazë të vendimeve *strike-out* të GJEDNJ-së. Nëpërmjet këtij mjeti, Gjykata e Strasburgut nuk bën thjesht një pranim mekanik të deklaratave të njëanshme të Qeverisë; ajo, në njëfarë mënyre, e ratifikon pranimin e cenimit të Konventës, pas një shqyrtimi të kujdesshëm të rrethanave, nivelit të dëmshpërblimit të ofruar dhe angazhimeve të tjera të ndërmarra nga Qeveria në emër të Shtetit kontraktor. Po aq e vërtetë është që GJEDNJ ruan kompetencën e mospranimit të një UD nëse, ndër të tjera, ajo konkludon se “kështu e kërkon respektimi i të drejtave të njeriut...” (shih nenin 37 (1) të Konventës). Një tjetër garanci është se Gjykata mund ta rivendosë çështjen për shqyrtim nëse Qeveria nuk i përmbahet angazhimeve të ndërmarra.

Vendimet *strike-out* janë një mekanizëm i dobishëm i përdorur nga GJEDNJ-ja për zgjidhjen e çështjeve të përsëritura dhe reduktimin e stokut. Nëse legjislacioni ynë aktual gjykohet se nuk e lejon rishikimin e vendimeve të formës së prerë në bazë të një vendimi të tillë të GJEDNJ-së – konkluzion për të cilin personalisht nuk shoh motive të forta – kjo mund të bëjë të nevojshme ndërhyrjen e Kuvendit për të bërë rregullimet e nevojshme ligjore.

Mars 2026

⁸ Sipas nenit 71/c § 3: “Nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur më parë mbi një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t’i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesit gjyqësor.”